



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË

VENDIM

Nr. 13 datë 20.11.2025

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 15 datë 17.02.2020, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 20/11/ 2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 25/11/2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Dino Selimi

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Vladimir BAKIAJ

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Mjaftoni ZERAJ



Kryetar i Këshillit

Arben GUMENI



BASHKIA TEPELENË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr.13 prot.

Tepelenë, më 20.11.2025

Procesverbal

PROCESVERBAL

I mbajtur më datë **20.11.2025**, ora **10:00**, në zyrën e Këshillit Bashkiak Tepelenë, ku u zhvillua mbledhja e **Kryesisë së Këshillit** për miratimin e rendit të ditës së mbledhjes së radhës.

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes:

1. Z. Vladimir Bakiaj
2. Znj. Mjaftoni Zeraj

Takimin e hapi N/Kryetari i Këshillit, Znj. Mjaftoni Zeraj e cila përshëndeti të pranishmit dhe sqaroi se mbledhja zhvillohej për miratimin paraprak të rendit të ditës dhe përcaktimin e datës së mbledhjes së ardhshme të Këshillit Bashkiak për muajin Nentor.

Rendi i ditës i propozuar për mbledhjen e ardhshme:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 31.10.2025.
3. **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Tetor 2025.”
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Tetor 2025.”
5. **Projektvendim:** “Për miratimin e planit të punës, planit të konsultimeve dhe planit të buxhetit të këshillit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2026”
6. Prezantim i Raportit të performancës së Bashkisë Tepelenë për vitin 2024
7. Çështje të tjera
8. Kërkesa ankesa të qytetarëve.

Pas diskutimeve, të gjitha pikave të mësipërme Kryesia e Këshillit vendosi me unanimitet që mbledhja e ardhshme e Këshillit Bashkiak Tepelenë të zhvillohet më datë **25.11.2025**, ora **11:00**.

Kryetari deklaroi mbylljen e mbledhjes.

KRYESIA E KËSHILLIT

Arben Gumeni

Znj. Mjaftoni Zera

Z. Vladimir Bakiaj

Z. Dino Selimi

SEKRETARI KËSHILLIT

Valbona Cela

